



Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Bashkangjituni!

Takimi i Rregullt i RrGGK-së
7 Qershor 2013, 11:00,
Hotel Prishtina, Prishtinë

Premiera e dokumentarit historik:
“Sikur të mund të vallëzonim”
8 Qershor 2013, 11:00,
Kinemaja ABC

Në këtë Numër

1325 Fakte & Fabula Arrin në NATO, GjND, GP të KB.....2

New School, RrGGK Shfaqin Filmin e Parë të Historisë Gojore.....2

Fondacioni “Çifti Buçinca” Njeh Kontributin Jetësor të Çiftit në Arsimitin e Vajzave.....3

Anëtarët e RrGGK Zhvillojnë Shkathtësitë mbi Marrëdhëniet me Publikun.....3

Artpolis Organizon Festivalin: “Femmes Fatales”.....4

OJQ Pehja Ofron Informata mbi Kancerin e Gjirit.....4

Gratë nga “Medica Kosova” Vizitojnë Stambollin.....4



Faqja në Facebook
Grupi në Facebook



Lista e dërgesave të E-Lajmeve

RrGGK Fillon Iniciativën për Mbledhjen e Fondeve: Na përkrahni!

Ndihma e donatorëve në Kosovë, veçanërisht financimi i dedikuar për shoqërinë civile, duket se do të zvogëlohet gjatë dekadës së ardhshme. Ne, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) nuk duam që ndërrimet nga financimet e huaja të rrezikojnë punën tonë të vazhdueshme në shërbimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave në Kosovë dhe më gjerë. Prandaj, nisëm një iniciativë të re për mbledhjen e fondeve në Dhjetor 2012. Që atëherë, RrGGK ka mbledhur **\$4,810 (€3,681)** nga individë në SHBA dhe Shqipëri. Nga ky financim, \$1,500 (€1,135) janë vënë nën menjanë për Fondin e Qëndrueshmërisë së RrGGK-së, i cili mbështet shpenzimet e rëndësishme të cilat RrGGK nuk mund t'i mbulojë me financim nga donatorët tradicionalë, si dhe vizionin afatgjatë të RrGGK-së për mbledhjen e fondeve (klikoni [këtu](#) për informata lidhur me vizionin tonë).

Vizitoni [uebfaqen tonë](#) për të mësuar se si mund të përkrahni RrGGK-në!

Shuma tjetër prej \$3,310 (€2,546) e mbledhur deri më tani është dedikuar për Iniciativën e Historisë Gojore ([shih më poshtë](#)). Një mbështetës praktik ka rënë dakord që të kombinojë dollar-për-dollar çdo donacion të bërë për këtë Iniciativë!

Falë sponsorit tonë fiskal, [East-West Management Institute](#) në New York, personat që jetojnë në SHBA tani mund të ofrojnë donacione me zbritje-taksash me çek ([klikoni](#) për informata) ose me [kredit kartelë](#).

Ne falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar tashmë, dhe ne shpresojmë që të tjerët do të konsiderojnë që të bëhen përkrahës të RrGGK sot!

Vizitoni Uebfaqen Tonë të Freskuar

RrGGK ka shtuar rubrika dhe karakteristika të reja në uebfaqen e saj. Rubrika “[Anëtarët](#)” përfshinë informata për secilën nga organizatat e ndryshme anëtare, në renditje alfabetike, sipas komunës dhe sipas fushës së ekspertizës (p.sh. ekonomi, shëndetësi). Ky mund të jetë një burim vital për individët dhe organizatat në Kosovë dhe jashtë vendit që kërkojnë të identifikojnë partnerët. Rubrika “[Fondi i Grave të Kosovës](#)” ofron informata për programin tonë të granteve të lansuar së fundi, përfshirë suksesin e përfituesve të granteve deri në këtë datë dhe mënyrën se si të aplikojnë. Rubrika jonë e “[Burimeve](#)” lehtëson çasjen në hulumtime dhe publikime, të reja dhe të vjetra, lidhur me barazinë gjinore, gratë në politikë, gratë dhe ekonomia, gratë dhe shëndeti, dhuna në familje dhe trafikimi në Kosovë, duke lehtësuar çasjen në informata që nganjëherë është e vështirë të gjinden. Rubrika “[Media](#)” përfshinë mbulimin mediatik të RrGGK-së, kumtesat për media dhe videot. Ju lutem vizitoni www.womensnetwork.org dhe na tregoni se çka mendoni për faqen e re duke na shkruar në info@womensnetwork.org.

1325 Fakte & Fabula Arrin në NATO, GjND, GP të KB

Në vitin 2011, RrGGK donte të bënte revolucion në mënyrën se si organizatat e grave monitorojnë, raportojnë dhe avokojnë mbi zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Pas dy raporteve monitoruese të pa-“konsultuara” mbi zbatimin e RKSKB 1325 në Kosovë, RrGGK vendosi të shkruante librin 1325 Fakte & Fabula, që përdor bashkë “faktet” dhe “fabulat” për të ilustruar zbatimin e Rezolutës në Kosovë në dekadën e fundit. Siç shpjegon Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së Igballe Rogova në hyrje të librit, “dua që ky publikim të shihet jo vetëm si raport, por më shumë si diçka që ju bën të qeshni dhe të thuani, ‘Si mund të ndodhë kjo?’”

Në mesin e promovuesve më të rinj të 1325 Fakte & Fabula është edhe Përfaqësuesja Speciale e NATO-s për Gra, Paqe dhe Siguri, Mari Skåre. Gjatë një takimi në zyret e RrGGK-së më 17 Prill, ajo është shprehur që: “Shpresoj që do t’i realizoni ndryshimet që i keni arritur në ngritjen e pjesëmarrjes së grave në paqe dhe siguri përmes avokimit me 1325”.. Ajo nxiti përfaqësuesit e tjerë të NATO-s që ishin prezentë, përfshirë edhe Forcat e NATO-s për Kosovë (KFOR) që ta lexojnë librin.

Më pas, më 25 Prill, një delegacion i RrGGK-së informoi Grupin Punues të OJQ-ve për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në KB mbi avokimin e RrGGK-së në të kaluarën dhe të tashmen lidhur me zbatimin e RKSKB 1325 në Kosovë. Kjo përfshinte avokimin për drejtësi të RrGGK për personat që kanë vuajtur dhunë seksuale gjatë luftës. RrGGK siguroi kopje të 1325 Fakte & Fabula për anëtarët e Grupit Punues (GP).

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) në Hagë, tash së voni, ka porositur një kopje të 1325 Fakte & Fabula për bibliotekën e tyre të përhershme.

Vitin e kaluar, libri arriti në duart e liderëve në mbarë botën, duke përfshirë edhe Sekretaren e Shtetit të SHBA-ve Hillary Clinton, Deputetët e Parlamentit Evropian dhe shumë aktivisteve tjera.

Botimi fillestar i librit ishte financuar nga Austrian Development Agency dhe më pas është vetë-financuar përmes shitjes jo-fitimprurëse të librit. Ju mund të shkarkoni një kopje elektronike falas, apo të porositni një kopje për 5€ plus dërgesa, duke shkruar në info@womensnetwork.org.



Amy Hillock prezanton në bibliotekën e GjND-së kopjen e re të 1325 Fakte & Fabula të RrGGK-së. Amy ka ndihmuar hulumtimin dhe shkrimin e librit gjatë punës praktike në RrGGK. Ajo i tërhoqi vëmendjen GjND-së mbi librin këtë vit gjatë punës praktike të saj atje.

New School, RrGGK Shfaqin Filmin e Parë të Historisë Gojore

Në Prill të vitit 2013, RrGGK në bashkëpunim me New School shfaqën produktin e parë të Inicativës së tyre të përbashkët të Historisë Gojore në New York. Filmi i shkurtër prezantonte historinë gojore të Safete Rogovës, një ndër aktoret e para të Kosovës dhe aktiviste e dalluar e të drejtave të grave. Dy grupe shikuesish morën pjesë në shfaqjet e këtij filmi: së pari në New School dhe më pas në ngjarjen e mbledhjes së fondeve në Restoran Macellaria.

Iniciativa e Historisë Gojore synon të dokumentojë historitë jetësore të kosovarëve para, gjatë dhe pas luftës. Këtë vit, përveç mbledhjes së historive individuale shpesh, ekipi planifikon të krijojë një uebfaqe me mundësi kërkimi, interaktive, multi-mediale që përmban transkriptat në shqip dhe anglisht, filma të shkurtër, fotografi dhe çizimet e zërit nga këto intervista.

Iniciativa udhëhiqet nga një Grup i Historisë Gojore që përfshin RrGGK, New School dhe hulumtues, akademikë, krijues filmash dhe praktikantë të tjerë të ndryshëm. RrGGK ka kënaqësinë të pranojë praktikantë nga New School edhe këtë verë për të vazhduar krijimin e arhivës të Historisë Gojore, përfshirë Catherine McGahan, Ericka Kriedel, Amber Kiwan dhe Jung Chao. Profesoresha Anna di Lellios dhe kontribuesit kosovarë poashtu do të ofrojnë vullnetarisht kohën e tyre këtë verë për këtë Iniciativë të rëndësishme.

Nëse jeni të interesuar të përfshiheni vullnetarisht në Iniciativën e Historisë Gojore, ju lutemi na shkruani në info@womensnetwork.org. Ne ende jemi duke kërkuar krijues filmash, regjisorë filmash, intervistues dhe përkthyes që duan të kontribuojnë me orar të plotë apo me gjysmë orari.



Në njërin prej filmave të parë të shkurtër të Inicativës së Historisë Gojore është Safete Rogova, një prej aktoreve të para kosovare dhe aktiviste për të drejtat e grave.

Fondacioni “Çifti Buçinca” Njeh Kontributin Jetësor të Çiftit për Arsimimin e Vajzave

Më 23 Maj, një Gala Mbrëmje shënoi krijimin e Fondacionit për Arsimimin e Vajzave “Çifti Buçinca”. Për më shumë se 60 vjet, Naxhie dhe Fahri Buçinca kanë punuar në arsimimin formal dhe joformal me vajzat. Tani në moshën e tyre 80 vjeçare, Fondacioni “Çifti Buçinca” është krijuar për të njohur kontributin e Çiftit Buçinca dhe për të vazhduar iniciativën e tyre për t’iu mundësuar vajzave qasjen në edukim në vitet e ardhshme.

Në këtë mbrëmje Gala u mbledhën një shumë fillestare prej €23,969 për Fondacionin “Çifti Buçinca”, kryesisht prej bizneseve lokale, organizatave dhe individëve. Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së Igballe Rogova kontribuoi në komitetin organizativ.

Gjatë mbrëmjes, Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga ndau për çiftin Buçinca Medaljen Presidenciale të Meritave për punën e tyre.

Çifti Buçinca kanë kontribuar për ndryshime sociale në Ulqin të Malit të Zi dhe nëpër Kosovë, veçanërisht në Komunën e Vushtrrisë ku ata fokusuan punën e tyre. Naxhie Alibegaj Buçinca punoi shtëpi për shtëpi në fshatrat e Krajës në Komunën e Ulqinit për pesë vite dhe në Komunën e Vushtrrisë për më shumë se 60 vite. Fahri Buçinca filloi të punonte si mësues në moshën 15 vjeçare, duke krijuar shkollën e parë fillore në vitin 1954. Nga viti 1981 deri më 1989, kur shkollat e kontrolluara nga serbët mbyllen dyert e tyre për nxënësit shqiptarë, ai ndërtoi shkolla të reja në fshatrat e Vushtrrisë, Skenderajit dhe Lipjanit. Ata poashtu punuan për të mbajtur gjallë kulturën shqiptare gjatë dekadës së pushtimit të viteve të nëntëdhjeta përmes Grupit të tyre të Veteranëve të Arsimit. Përpjekjet e tyre për mbledhjen e fondeve kanë siguruar fonde nga individë, donatorë dhe biznese të cilat mundësuan që mijëra vajza të vazhdojnë shkollimin e tyre në nivele më të larta.

“E kam ditur që çifti Buçinca kanë bërë punë të jashtëzakonshme për shkollimin e vajzave gjatë jetës së tyre, por vetëm sot e dëgjova historinë e vërtetë dhe isha e mahnitur nga arritjet e tyre,” tha Emine Berisha që mori pjesë në Gala Mbrëmje.

RrGGK poashtu nderoi kontributin e çiftit Buçinca me një Çertifikatë Mirënjohjeje, duke shprehur admirim për kontributin e tyre. RrGGK ofroi një donacion në shumë prej €1,000 për Fondacionin “Çifti Buçinca”.



Kontributi jetësor i çiftit Buçinca për mbështetjen e qasjes së vajzave në arsimim u njoh nga Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga dhe përmes Fondacionit të ri për Arsimim e Vajzave “Çifti Buçinca.”



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Realizim, mbledhje dhe promovim i grupeve të grave dhe të vajzave

Në emër të
Mirënjohjeje

prej Naxhie e Fahri Buçinca

prej kontributit të tyre shumëvjeçar
në arsimimin e vajzave

22.05.2012

RrGGK nderoi me një Çertifikatë
Mirënjohjeje çiftin Buçinca gjatë
mbrëmjes së krijimit të Fondacionit
“Çifti Buçinca”.

Anëtarët e RrGGK Zhvillojnë Shkathtësitë mbi Marrëdhëniet me Publikun

Më 19 Prill, RrGGK mbajti një punëtori njëditore mbi marrëdhëniet me publikun në Prishtinë, duke realizuar kërkesat e anëtareve. Anëtarët diskutuan përsfidat me të cilat ato ballafaqohen në Marrëdhëniet me Publikun (MP), nevojat e tyre dhe strategjitë e mundshme për promovimin e punës së tyre. Pastaj ato mësuan teknika praktike për shkrimin e kumtesave efektive për media.

“Të gjitha anëtarët duhet të marrin pjesë në këto punëtori, edhe ato që kanë përvojë,” tha një pjesëmarrëse e punëtorisë. “Gjithmonë ka diçka të re për të mësuar.”

Anëtarët e RrGGK shpalluan njohuritë e tyre të reja në praktikë, duke shkruar kumtesa për media që më vonë morën kritika konstruktive nga pjesëmarrëset e tjera të punëtorisë.

“Më pëlqeu shumë kjo punëtori”, tha një tjetër pjesëmarrëse. “Është shumë e nevojshme të mësojmë për marrëdhëniet me publikun.”

Gjatë vitit 2013 RrGGK do të mbajë një punëtori më të avancuar mbi marrëdhëniet me publikun, bazuar në kërkesat e anëtareve. Anëtarët do të kenë mundësinë të mësojnë teknika për promovimin e punës së tyre me pak ose pa shpenzime.



Pjesëmarrëset bashkëpunojnë, për të krijuar një skicë të kumtesës për media gjatë punëtorisë së MP të RrGGK.

Artpolis Organizon Festivalin: “Femmes Fatales”

Më 27-30 Maj, OJQ [Artpolis](#) organizoi festivalin e parë në Kosovë për të drejtat e njeriut për të shfaqur artistet femra nga regjioni. “Femmes Fatales” u mbajt në Teatrin Oda në Prishtinë.

Festivali ofroi një platformë për të festuar kreativitetin e grave përmes artit, tha Zana Hoxha-Krasniqi, Drejtoreshë Ekzekutive e Artpolisit. Ai “krijoi një forum për gratë artiste në Kosovë dhe iu ofroi atyre mundësinë që të shpalosin punën e tyre, duke i inkurajuar gratë të shkëmbejnë idetë e tyre dhe duke i lidhur ato me organizata të grave.”

Katër ditë u shfaqën pjesë teatrale, filma, ekspozita, koncerte, diskutime, promovime librash dhe performanca nga gra artiste nga Kosova dhe regjioni.

“Është një gjë shumë e mirë që kjo iniciativë u ndërmor në Kosovë dhe që është regjionale,” tha një shikuese. “Ne kemi shumë gra artiste dhe aktiviste që kanë shumë kreativitet”.

Artpolis është një organizatë anëtare e RrGGK-së që synon të ndikojë në zhvillimin kulturor përmes dialogut social, në veçanti në mes të rinjve, grave dhe fëmijëve. Ajo përdorë teatrin si një mjet për fuqizim dhe për ngritjen e vetëdijes tek publiku për të drejtat e grave.



OJQ Prehja Ofron Informata për Kancerin e Gjirit

“Shumë gra heshtin... Ato mendojnë që është turp të tregojnë për sëmundjen e tyre, kështu që durojnë dhimbjen. Ato ndihen keq për tu treguar burrave të tyre që janë të sëmura sepse e dinë që trajtimi shëndetësor do t’iu kushtojë shtrenjtë dhe familjet e tyre nuk kanë para të mjaftueshme.”

Pasiguria e grave për të kërkuar ose paguar për kujdes shëndetësor, e lëre më për ekzaminimet parandaluese, ishin ndër arsyet se pse [Qendra e Gruas “Prehja”](#) vendosi të iu ofrojë pjesëmarrëseve informata mbi metodat e kryerjes së vet-ekzaminimeve për kancer të gjirit brenda shtëpisë së tyre.

“Situata socio-ekonomike na ka vënë në të tilla kushte. Ne duhet të mendojmë në secilin cent: si do t’i shpenzojmë dhe se si ta kalojmë muajin,” tha Naza, një pjesëmarrëse.

Më 24 Maj, Prehja organizoi një tryezë me ligjëratën e titulluar “Ta Mbrojmë Shëndetin Tonë” në shkollën fillore Shotë Galica fshatin Syriganë të Komunës së Skenderajit. Dr. Mejreme Maloku ishte prezente, duke iu treguar pjesëmarrëseve se si të kryejnë vet-ekzaminim. Gra të të gjitha moshave morën pjesë, nga adoleshente të interesuara që të jenë proaktive e deri tek gra më të vjetra potencialisht të rrezikuara. Pjesëmarrëset morën informata lidhur me operimet dhe shanset e rishfaqjes.



Gratë marrin pjesë në punëtorinë e Prehjes mbi parandalimin e kancerit të gjirit.

Më pas, gratë vendosen që në grupe të shkojnë dhe të bëjnë ultrazërin për të testuar kancerin e gjirit. Ato shfrytëzuan informacionet nga Prehja dhe RrGGK për të gjetur fonde për transportin deri në spital.

Prehja, me lokacion në Skenderaj, ka organizuar punëtori dhe diskutime të ndryshme për gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit. Iniciativën e organizatës Prehja e ka mbështetur [Fondi i Grave të Kosovës](#) i RrGGK-së.

Gratë nga “Medica Kosova” Vizitojnë Stambollin

Njëzetë e tetë gra dhe anëtare të stafit nga organizata anëtare e RrGGK-së [Medica Kosova](#) vizituan Stambollin më 16-20 Prill 2013. Vizita kishte për qëllim të ndihmonte procesin e rehabilitimit për gratë që kanë përjetuar humbje të familjarëve gjatë luftës, si dhe forma të ndryshme të dhunës. Kjo vizitë gjeti mbështetje nga Ministria për Familje dhe Politika Sociale (MFPS) në Turqi përmes Ambasdës Turke në Kosovë.

“Me të vërtetë e çmojmë ndihmën e MFPS-së për këtë vizitë. Vizita në Turqi është pjesë e procesit të shërimit tonë,” tha njëra nga klientet e Medica Kosovës, e mbijetuar nga lufta në Kosovë.

Gjatë vizitës së tyre, grupi i grave u takua me Znj. Fatma Şahin, Ministre për Familje dhe Politika Sociale; Sebahate Spahiu, gruaja e Ambasadorit të Kosovës në Turqi, dhe Rrahmi Morina, Konsull i Përgjithshëm.

Shoqata e Prishtinasve (ShP) në Stamboll me mirësi dhe ngrohtësisht iu uroj mirëseardhje vizitoreve. “Ne jemi të gëzuar që po i takojmë ‘motrat’ tona nga Kosova,” tha një përfaqësues i ShP-së.

Vizita në Stamboll poashtu përfshiu vizita në organizata dhe qendra trajnuese të ndryshme. Kjo vizitë ofroi një mundësi të mirë për shkëmbim informatash, përvojash dhe ideshë.